



GEOTECHNICAL INVESTIGATIONS, GEOTECHNICAL & GEOPHYSICAL STUDIES,
LABORATORY TESTING FOR GEOTECHNICAL & CONSTRUCTION MATERIALS

INVESTIGIME GJEOLGJIKE, STUDIME GJEOTEKNIKE & GJEOFIZIKE,
LABORATOR PER KRYERJEN E PROVAVE TE MATERIALEVE TE NDERTIMIT
& STUDIMEVE GJEOTEKNIKE



LT 067 11 03 21

STUDIM

INXHINIERO-SIZMOLOGJIK I ZONES KU ESHTË NDERTUAR "PALLATI NR.26380,

ME 13 KATE DHE 1 KAT PODRUM", NE RRUGEN "ILJAZ REKA", DURRES



Lab P-12



QM 7,2,1

Lab D - 12,3
(710)

Tirane, Korrik 2021

Adresa: Autostrada Tirane-Durres km 12, Picar Vore
Kontakt, Tel: +355 4 4500 884; +355 4 4500 885
Mob: ++ 355 682074332; Mob: ++ 355 68 2031 906; Mob: ++ 355 684071577
E-mail: skender.alkja@alteageostudio.com
Website: www.alteageostudio.com



EN ISO 9001:2015 No. 010140786
SCC** 2011 No. 20 106 122007136
EN ISO 14001 2015 No. 04 015005
OHSAS 18001:2007 No. 03012019
Pass 99 2012 No. 02613005



GEOTECHNICAL INVESTIGATIONS, GEOTECHNICAL & GEOPHYSICAL
STUDIES, LABORATORY TESTING FOR GEOTECHNICAL &
CONSTRUCTION MATERIALS

INVESTIGIME GJEOLGJIKE, STUDIME GJEOTEKNIKE & GJEOFIZIKE,
LABORATOR PER KRYERJEN E PROVAVE TE MATERIALEVE TE NDERTIMIT
& STUDIMEVE GJEOTEKNIKE



LT 067 11 03 21

STUDIM

INXHINIERO-SIZMOLOGJIK I ZONES KU ESHTË NDERTUAR "PALLATI NR.26380,

ME 13 KATE DHE 1 KAT PODRUM", NE RRUGEN "ILJAZ REKA", DURRES

Autor: Prof. Dr. Shyqri ALIA

Ing. Gjeolog Skender ALLKJA

Ing. Gjeolog Besian XHAGOLLE



Porosites: "BASHKIA DURRES"

Adresa: Autostrada Tirane-Durres km 12, Picar Vore
Kontakti, Tel: +355 4 4500 884; +355 4 4500 885
Mob: ++ 355 682074332, Mob: ++ 355 68 2031 906; Mob: ++ 355 684071577
E-mail: skender.allkja@alteageostudio.com
Website: www.alteageostudio.com

TÜV
AUSTRIA
HELLAS

EN ISO 9001:2015 No. 010140786
SCC**2011 No. 20 106 122007136
EN ISO 14001:2015 No. 04 016008
OHSAS 18001:2007 No. 03012019
Pass 99/2012 No.02613005

	Tabela Permbledhese	
1.0	HYRJE	2
2.0	KUADRI GJEOLGO-TEKTONIK NE ZONEN RRETH ZONE SE DURRESIT	3
3.0	AKTIVITETI SIZMIK I ZONES SE DURRESIT DHE ZONES PERRETH	4
	3.1 Sizmiciteti Historik	4
	3.2 Sizmiciteti Instrumental	6
4.0	MODELI GJEOTEKNIK I SHESHIT TË NDËRTIMIT	10
	4.1 Klasifikimi i Truallit te Sheshit te Ndertimit.....	10
5.0	VLERËSIMI PROBABILITAR I RREZIKUT SIZMIK I SHESHIT TË NDËRTIMIT NË KUSHTE SHKËMBORE TË TRUALLIT	12
6.0	VLERESIMI I RREZIKUT SIZMIK TE SHESHIT TE NDERTIMIT NE KUSHTET KONKRETE TE TRUALLIT ME ANEN E PROGRAMIT KOMPJUTERIK "SHAKE 2000"	13
	6.1 Reagimi Dinamik i Modelit Gjeoteknik te Sheshit te Ndertimit.....	13
	6.2 Nxitimi Maksimal (PGAm_{ax}) dhe Faktori i Amplifikimit Dinamik te Truallit (FA) 15	15
	6.3 Spektrat e Reagimit te Nxitimit te Lekundjeve te Forta	17
	6.4 Periodat e Vibrimit te Truallit.....	18
7.0	SPEKTRAT E PROJEKTIMIT	20
	7.1 Spektri i Projektimit Sipas Kodit Shqiptar të Projektimit KTP N.2-89	20
	7.2 Spektri i Projektimit Sipas Eurokodit 8	23
8.0	PËRFUNDIME	25
9.0	LITERATURA	26
10.0	HYRJE	28
11.0	MASW	28
12.0	PERPUNIMI I MATJEVE	31
13.0	INTERPRETIMI I PERFOUNDIMEVE.....	38
14.0	REFERENCA	39

1.0 HYRJE

Me kërkesën e bërë nga “BASHKIA DURRES”, kompania “ALTEA & GEOSTUDIO 2000” kreu studimin inxhiniero-sizmologjik te zones ku eshte ndertuar “Pallati Nr. 26380, me 13 kate dhe 1 kat podrum” ne rrugen “Iljaz Reka”, Durres.

Ky studim inxhiniero-sizmologjik u mbështet në Punimin “Sizmiciteti, Sizmotektonika dhe Vlerësimi i Rrezikut Sizmik në Shqipëri” (Aliaj etj., 2010), të publikuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në Raportin mbi kushtet gjeologo-inxhinierike të sheshit në studim, të kryer nga Ing. Gjeolog Skender Allkja, Ing. Gjeolog Besian Xhagolli dhe Ing. Gjeoteknike Ardita Malaj (2021) dhe ne Raportin Sizmik me metodën e valeve sipërfaqesore të kryer nga Ing. Besian Xhagolli dhe Ing. Gjeolog Skender Allkja (2021).


Në këtë studim është kryer vlerësimi i rrezikut sizmik që mund të kërcënojë këtë shesh ndërtimi në kushte truallë shkembor nëpërmjet një metodologjie bashkëkohore probabilitare Cornell-McGuire.

Vlerësimi i rrezikut sizmik të sheshit në studim në kushtet specifike konkrete do të kryhet duke përdorur programin kompjuterik “SHAKE 2000” (G.A Ordonez, 2011, i përditësuar korrik 2016).

Rreziku sizmik është shprehur me anë të parametrave fizikë të lëkundjeve të truallit si pasojë e vibrimit të tij nga tërmetet, të tillë si nxitimi maksimal PGA dhe nxitimet spektrale SA për periodat e lëkundjes së truallit.

2.0 KUADRI GJEOLGO-TEKTONIK NE ZONEN RRETH ZONE SE DURRESIT

Qyteti i Durresit nga pikepamja gjeologjike ben pjese ne Ultesiren Pranadriatike. Kodrat e Durresit qe ndertojne krahun lindor te antiklinalit te Durresit perbehen nga formacione molasike Pliocenike te perfaqesuara nga depozitime argjilo-alevrolitike te suites "Helmesi". Depozitimet Kuaternare ndeshen ne gropen e Durresit ku shtrihen me diskordance mbi depozitimet Pliocenike. Fushe-gropa e Durresit perben nje sinklinal asimetric.



Simbolet tektonike	Mosha e shkëputjeve	Të dhënat sizmologjike
Shkëputje normale	-Pleistocen i mesëm-Holocen (ose Kuaternar)	4.5 (M 15.0)
Lart-rrëshqitje dhe mbihipje	-Pliocen-Plejstocen i poshtëm (ose Pliocen-Kuaternar)	5.0 (M 15.5)
Shtytje e djathtë	-Para-Pliocenike, aktive gjatë	5.5 (M 16.0)
Shtytje e majtë		6.0 (M 16.5)
Fleksurë		6.5 (M 17.0)
		M > 7.0

Fig. 1: Shkëputjet aktive që përcaktojnë skenarin e rrezikut sizmik për Rajonin Tiranë-Durrës (nga Aliaj, 2000).

3.0 AKTIVITETI SIZMIK I ZONES SE DURRESIT DHE ZONES PERRETH

Në zonimin sizmik mbarë botëror, Shqipëria zë vënd në brezin sizmik Alpin-Mesdhetar, i cili është nder me aktive ne bote. Rajonet që rrethojnë Shqipërinë përfshijnë një zonë tektonike mjaft të gjerë, të përbërë nga blloqe relativisht të shtangët si Adriatiku, disa sektorë të brezit Alpin, Alpeve, Karpateve, Vargmaleve Ballkanikë, Dinarideve, Helenideve, Harkut Helenik, brezit të Anadollit si dhe basenet e brendshme të Tirrenit, Egjeut, Panonian dhe Detit të Zi.

Në brezat e mësipërm, pjesa më aktive nga pikepamja sizmike është Egjeu dhe zona rrethuese e tij, ku bëjnë pjesë Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Çdo vit në këtë rajon (34-43o N; 18-30o E), ndodh të paktën një tërmet me $M > 6.5$ (Papazachos, 1989).

Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M < 3.0$), nga shumë tërmete të vegjël ($3.0 < M < 5.0$), nga tërmete të rrallë me madhësi mesatare ($5.0 < M < 7$) dhe shumë rrallë nga tërmete të fortë ($M > 7.0$).

Pergjithesisht termetet e shqiperise dhe rajoneve per reth kane vatra te cekta, thellesia e te cilave shkon nga 10 -25 km.

Zakonisht, sizmiciteti i një vëndi ndahet sipas dy periudhave: Te sizmicitetit historik dhe sizmicitetit instrumental. Sizmiciteti historik bazohet në informacionin e mbledhur nga burime të ndryshme dhe ka të bëjë me atë periudhë të historisë kur tërmetet ende nuk regjistroheshin në rrugë instrumentale. Sizmiciteti instrumental identifikohet me shekullin e 20-të.

3.1 Sizmiciteti Historik

Sizmiciteti historik i Shqipërisë është përshkruar në disa katalogë, si: Moreli 1942, Mihajlovic 1951, Shebalin et al., 1974, Sulstarova et al., 1975, Makropoulos & Burton 1981, Papazachos et al., 1989, etj.

Nga dëshmitë që ne zotërojmë sot, rezulton që qysh prej periudhës së shekullit III-II para Krishtit deri në ditët tona, Shqipëria është goditur prej 55 tërmetesh të fortë me intensitet $I_0 = VIII$ ballë (MSK-64), 15 prej të cilëve kanë patur intensitet $I_0 = IX$ ballë (MSK-64) (Fig.1). Prej këtyre 55 tërmeteve të një periudhe më shumë se 2000 vjeçare, 36 i takojnë shekullit të 19-të, gjë që na bën të mendojmë se numri i tërmeteve shkatërues të përmëndur më sipër është

i nënvlerësuar dhe se tërmete të tjerë shkatërues janë fshehur në errësirën e historisë. Në Fig. 2 paraqitet një hartë e epiqëndave të tërmeteve të forta të Shqipërisë të rene para vitit 1900. Ndërsa më poshtë po japim përshkrime të shkurtra për disa nga tërmetet më të forta që kanë goditur kryesisht zonën rreth Durrësit, zona në afërsi të sheshit të ndërtimit në studim.




Fig. 2: Epikëndrat e tërmeteve të Shqipërisë për periudhën 58-1900 ($M > 6.0$)

Tërmeti i vitit 58 para erës së re, shkatërroi qytetin e Durrësit; kishte intensitet 8,5 balle të shkallës MSK-1964.

Në vitin 334 të erës sone, Durrësi u godit nga një tërmet shkatërrues; intensiteti i këtij tërmeti vlerësohet 8,5 balle shkallë MSK-1964 (Sulstarova e Koçiaj, 1975).

Në vitin 346, Durrësi shkatërrohet nga një tërmet i fuqishëm; intensiteti i këtij tërmeti është 9 balle të shkallës MSK-1964.

Në vitin 506, Durrësi dhe rajonet rreth tij shkatërrohen; intensiteti i këtij tërmeti është vlerësuar 8,5 balle shkallë MSK-1964.

Në vitin 521, Durrësi demtohet shumë rëndë; intensiteti i këtij tërmeti është vlerësuar 8 balle të shkallës MSK-1964.

Ne Mars te vitit 1273 (naten), Durresi u godit nga nje termet katastrofik; vetem Akropoli mbeti i pademtuar, ndersa ndertesat brenda tij u demtuan rende. U vrane shume njerez. Ata qe shpetuan emigruan nga Durresi ne vende te tjera deri ne Beograd. Goditja kryesore u pri nga paragoditje dhe u shoqerua me shume pas goditje deri ne fund te vitit. Intesiteti i termetit eshte vleresuar 9 balle te shkalles MSK-1964.

Ne vitin 1617, nga nje termet i fuqishem u demtua rende Kalaja e Krujes; Gjurmjet e ketij termeti dallohen edhe sot ne pjesen e mureve jugore te kalase. Intesiteti i ketij termeti eshte vleresuar 8 balle te shkalles MSK-1964.

Me 26 Gusht 1852, nje termet shume i forte shkaterroi Kishen e Shen Andonit ne Kepin e Rodonit. Intesiteti i ketij termeti llogaritet 8 balle te shkalles MSK-1964.

Me 16 Maj 1860, nje termet shume i forte shkaterroi fshatrat ne afersi te Ures se Beshirit (ne afersi te Tiranës). Intesiteti i ketij termeti eshte vleresuar 8 balle te shkalles MSK-1964.

Me 01 Shtator 1869 nje termet shkatoi shkaterrime ne qytetin e Durresit dhe ne rajonet rreth tij; pasgoditjet vazhduan deri me 28 dhjetor 1869. Intesiteti i ketij termeti eshte vleresuar 8 balle te shkalles MSK-1964.

Me 28 Shtator 1870 ne oren 05, qyteti i Durresit u godit nga nje termet qe shkaktoi shkaterrime ne kete qytet dhe demtime te lehta ne Elbasan. Lekundjet e ketij termeti jane ndjere fort ne Janine e ne Korfuz. Goditjet vazhduan per rreth tre muaj. Intesiteti i ketij termeti eshte vleresuar 8 balle te shkalles MSK -1964.

3.2 Sizmiciteti Instrumental

Vendosja në fund të shekullit të 19-të dhe veçanërisht në fillim të shekullit të 20-të e stacioneve sizmologjike në Europë, bëri të mundur evidentimin edhe të tërmeteve të ndodhur në Shqipëri dhe rreth saj. Në vartësi të dendësisë dhe modernizimit të stacioneve sizmologjike në Europë dhe në botë, mund të thuhet se tërmetet e Shqipërisë dhe rreth saj me magnitudë $MS=6.0$ (pra, me intensitet $I_0=VIII$ (MSK-64)), janë regjistruar nga stacionet sizmologjike qysh në fillim shekullit 20-të; Ato me magnitudë $MS=5.5$ (intensitet $I_0=VII$ (MSK-64)) qysh nga viti 1911; ato me $MS>5.0$ (intensitet $I_0>VI$ (MSK-64)), qysh në vitin 1940; ato me $ML=4.0$ (intensitet $I_0=IV-V$ (MSK-64)), qysh në vitin 1968, kurse ato me magnitudë $ML=2.5$, qysh nga 1976.

Stacioni i parë sizmologjik në Shqipëri, Stacioni i Tiranës, u ngrit në gusht 1968, ndërsa rrjeti sizmologjik i Shqipërisë filloi të ngrihet në vitin 1975. Në vitin 1984 Shqipëria kishte një rrjet të përbërë nga 13 stacione sizmologjike.

Me poshte po japim pershkrime te shkurtra per disa nga termetet me te forta qe kane goditur Shqiperine nga rajonin bregdetar afer Durresit, termetet qe kane influence me te drejtperdrejte me zonen e qytetit te Durresit ku parashikohet ndertimi i objektit ne studim.

Termeti i 18 Dhjetorit 1926

Ne Dhjetor te vitit 1926, Durresi dhe rajonet rreth tij u goditen nga nje seri termetesh shume te forte. Goditja e pare e forte ndodhi me 16 dhjetor ne ore 17 e 54 min; Ajo u pasua nga goditje te tjera te forta me 17 Dhjetor. Me 17 dhjetor ne oren 06 e 20 min, ndodhi nje goditje e forte e cila u pasua pas 11 minutash, ne oren 06 e 31 minuta nga nje goditje me e fuqishme qe demtoi Durresin e Shijakun; U shkaterruan dhe u demtuan shume shtepi. Kjo goditje kishte magnitudo $M_s=5.8$; ajo u shoqerua me shume goditje te tjera. Goditja e ores 06 e 31 min. u ndje si lekundje 5 balleshe ne Galatina (Itali) e 4 balle ne Otranto, Alessamo e Lecce; si dhe 4 balle ne Dubrovnik (Kroaci), Ulqin (Malin e Zi) e 3 balle ne Trepçe e Izvor (Kosove) (Fig. 3).

Demtimet me te medha u shkaktuan nga goditja e ores 11 e 39 min. te se njejtës dite; ajo kishte magnitudo $M_s=6.2$. Kjo goditje shkaterroi e demtoi shume rende shume godina ne Durres, Kavaje e Shijak se dhe ne fshatrat rreth tyre. Ne shkallen e demtimit padyshim kane influencuar dhe goditjet e forta qe paraprine ate te ores 11 e 39 min.

Ne Durres goditja e ores 11 e 39 min, shkaterroi shumicen e godinave; U rrezuan minarete e xhamive; nje porte e kalase se vjeter u shkaterrua plotesisht. Demtime te renda pesuan edhe disa ndertesa te ndertuara mire; ndersa ato me skelet beton arme pesuan demtime me te lehta.




Fig. 3: Harta e izosejsteve te termetit te 17 Dhjetorit 1926

Ne Kavaje u demtuan rende te gjitha shtepite dhe u keputen minaret e xhamive. Demtime te renda pesuan fshatrat Romanat, Bozazhijes, Ndroq e Rogozhine.

Midis Duresit e Shijakut pati dukuri te lengezimit te truallit te shfaqura me shatervane me uje te nxehte e sulfur dhe pseudovullkane balte rere e uje.

Termeti u ndje shume fort ne Tirane, ku populli doli ne panik nga shtepite; u ndje fort ne Shkoder, Berat, Lushnje, Elbasan. Ne Itali u ndje 5 balle ne Pulje; ndersa ne Greqi 4 balle ne Janine e Korfuz.

Intensiteti i termetit eshte vleresuar 9 balle te shkalles MSK-1964, Ky termet eshte shoqeruar nga shume pasgoditje te cilat vazhduan e gjate vitit 1927.

Termeti i 4 Shkurtit 1934

Ne oren 09 35 min (GMT) te 4 shkurtit te vitit 1934, nje termet i fuqishem goditi fshatrat e Ndroqit, Bozazhijes, Romanatit ku u shkaterruan 283 shtepi. Demtime serioze u shkaktuan

edhe ne qytetin e Durresit. Ne qytetin e Tiranës ka patur panik, por per deme nuk ka raportime. Termeti eshte shoqeruar me shume pasgoditje qe kane shqetsuar, per nje kohe te gjate, popullin e ketij rajoni. Termeti eshte ndjere si lekundje me intensitet 5 balle ne Vlore e 3 balle ne Bari e Taranto. Termeti ka patur magnitudo $M_s=5.8$ e intensiteti i vleresuar nga shkalla e demtimeve 8 balle te shkalles MSK-1964.

Termeti i 19 Gushtit 1970

Ne oren 02 01 min te 19 Gushtit 1970, nje termet me magnitudo $M_s=5.5$ goditi rende rrethin e Tiranës veçanerisht rajonin ne Jug-perendim, zonen e Vrapit e te Baldushkut si dhe qytetin e Kavajes; Ne Kavaje u demtuan rende 90 shtepi. Demtime te lehta pai ne Tirane, Elbasan, Peqin, Durres e Lushnje. Intensiteti maksimal i kesaj goditje eshte vleresuar 7 balle te shkalles MSK-1964. Ne territorin ne studim intensiteti i lekundjes ishte 6 balle.

4.0 MODELI GJEOTEKNIK I SHESHIT TË NDËRTIMIT

Rezulton se ne sheshin e ndertimit, jane ndeshur depozitime Kuaternare detaro-lagunore, te cilat u mbishtrihen depozitimeve molasike Miocenike te mesme-te sipërme.

Ne ndertimin gjeologo-inxhinierik te sheshit ne studim marrin pjese depozitime Kuaternare detaro-lagunore, te mbishtrira ne depozitimet Miocenike.

Pra, ne ndertimin gjeologo-inxhinierik te sheshit ne studim marrin pjese depozitime Kuaternare dhe shkembij te Miocenit te sipërme: nderthurje alevrolitesh, ranoresh dhe argjilitesh, te cilet ne zonen e studiuar mund te takohen ne thellesine 40-60 m.

Shpejtësia mesatare e valeve terthore per prerjen e trojeve dherore, te vendosur mbi shkembinjte rrenjesore, eshte llogaritur nga modeli gjeoteknik.

Nga matjet ne terren llogaritet shpejtësia mesatare e valeve terthore per pjesen e sipërme te prerjes, si vijon: $V_s, 30 = 165$ m/sek.

4.1 Klasifikimi i Truallit te Sheshit te Ndertimit

Sheshi i ndertimit, nga pikepamja e shtresave qe e ndertojne ate, klasifikohet truall i kategorise III-te sipas Kodit Shqiptar te Projektimit KTP-N.2-89, dhe ne baze te shpejtësise mesatare te valeve terthore per pjesen e sipërme te prerjes $V_s, 30 = 165$ m/sek klasifikohet truall i klases "D" sipas Eurokodit 8 (EC-8, 2003), si ne tabelat me poshte:

KATEGORIA E TRUALLIT	PERSHKRIMI LITOLGJIK DHE HIDROGJEOLGJIK
I	a. Formacione shkembore: magmatike, sedimentare (konglomerate, ranore me cimentim karbonatik dhe silicor, gelqerore, dolomite) dhe te serise efuzivo-sedimentare (diabaze, rreshpe te kuq, rreshpe silicore etj), te forta, te paaksidentuara nga tektonika, karsti dhe proceset e tjetersimit. b. Formacione flishore dhe te serise rreshpore me fortessi mesatare te paaksidentuara nga tektonika dhe tjetersimi (nderthurje argjilite alevrolite, ranore e rreshpe, gipse, konglomerate; ranore me cimentim argjilor, gipsor e argjilo-ranor).
II	a. Formacione shkembore me cashmeri shume te zhvilluar dhe shume te tjetersuar. b. Formacione zallishtore suargjilore te ngjeshura ose mesatarisht te ngjeshura, pavaresisht nga lageshtia. c. Formacione te shkrifeta: 1. Surera, suargjila e argjila me ose pa permbajtje te materialit coprizor, ne gjendje plastike dhe elastike te forte me lageshti. 2. Rera e zhavorre te ngjeshura dhe mesatarisht te ngjeshura me lageshti.
III	a. Formacione te shkrifeta: 1. Rera kokerrtrashe, kokerrmesme dhe kokerrimet, rera pluhurore me nivel uji prane siperfaqes; 2. Argjila dhe suargjila plastike te buta deri rrjedhese.

Klasifikimi i truallit sipas Kodit Shqiptar te Projektimit KTP-N.2-89

Tipi i truallit	Pershkrim i profilin stratigrafik	Parametrat		
		Vs30 (m/s)	NSPT (goditje/30cm)	cu (kPa)
A	Shkemb ose formacion tjetër gjeologjik i ngjashëm me shkemb, duke përfshirë të shumtën 5m material me të dobët në sipërfaqe	>800	-	-
B	Depozitime me rere shume te ngjeshur, zhavorr ose argjile shume te ngurte, te pakten me deri disa dhjetra metra trashesi, te karakterizuara nga nje rritje graduale e vetive mekanike, me rritjen e thellesise.	360-800	>50	>250
C	Depozitime te thella me rere te ngjeshur ose gjysme te ngjeshur, zhavorr ose argjile e ngurte, me trashesi nga disa dhjetra metra ne disa qindra metra.	180-360	15-50	70-250
D	Depozitime dherash te palidhur deri gjysem te palidhur (me ose pa disa shtresa te buta lidhese kohezive), ose depozitime dherash qe ne masen mbizoteruese jane te buta (te dobeta) deri ne te forta, te lidhura.	100-180	<15	<70
E	Nje profil dheu qe ka nje shtrese siperfaqesore aluvionesh me vlera vs te tipit C dhe D dhe trashesi qe ndryshon nga 5m deri ne 20m, e vendosur mbi nje material te ngurte mbeshtetes me Vs>800 m/sek.			
S1	Depozitime qe kane ose permbajne nje shtrese prej te pakten 10m trashesi me argjila/lymra te buta me tregues te larte plasticiteti dhe nivel te larte ujerash nentokesore.	<100	-	10-20
S2	Depozitime dherash te lengezueshme, argjilash te ndjeshme ose cdo profil tjetër qe nuk përfshihet në tipat A-E			

Klasifikimi i truallit sipas Eurokodit 8

5.0 VLERËSIMI PROBABILITAR I RREZIKUT SIZMIK I SHESHIT TË NDËRTIMIT NË KUSHTE SHKËMBORE TË TRUALLIT

Vleresimi i rrezikut sizmik te sheshit te ndertimit eshte kryer me metoden probabilitare Cornell-McGuire. Vlerat e shpejtimit maksimal te truallit - PGA jane llogaritur per truall shkembor me $V_{s,30} = 760$ m/sek, per nivel probabiliteti: 10 % probabilitet tejkalmimi ne 50 vjet (koha e ekspozimit ose e jetegjatesise ekonomike), qe u korespondon periodes se perseritjes te termetetit: 475 vjet, ne perputhje te plote me Eurokodin 8. Keshtu, nga llogaritjet e rrezikut sizmik per zonen e qytetit te Durrës, ku ze vend sheshi i ndertimit ne shqyrtim, vlerat e PGA jane reth 0.268 g per kushte trualli shkembor dhe per probabilitet 10%/50 vjet (Aliaj etj., 2010, shih Fig. 4).

Rezultatet e rrezikut sizmik per probabilitet 10%/50 vjet ne kushte trualli shkembor jane permbledhur ne Tabelen 1.

Tabela 1: Vlerat e llogaritura te parametrave kryesore te rrezikut sizmik te sheshit te ndertimit per periode perseritje 475 vjet, ne truall shkembor.

PGA	Sa (0.2 sek)	Sa (0.5 sek)	Sa (1.0 sek)	Sa (2.0 sek)
0.268 g	0.626 g	0.359 g	0.183 g	0.078 g

Vlerat e shpejtimit maksimal te truallit - PGA dhe te shpejtimit spektral - Sa per perioda 0.2-0.5 sekonda korespondojne energjise periudhe-shkurter, e cila do te kete efektin me te madh mbi strukturat periudhe-shkurter, ne ndertimet deri afer 7 kate te larte, ndertimet me te zakonshme sot ne Bote. Vlerat e shpejtimit spektral periudhe-gjate: 1.0 sek., 2.0 sek. etj. paraqesin nivelin e lekundjes te truallit qe do te kete efektin me te madh ne strukturat me periudhe-gjata, ne ndertimet 10 kate te larte e me teper, ne urat etj.




Fig. 4: Harta e Akseleracionit Maksimal ne truall shkembor per probabilitet 10% / 50 vjet ose 475 vjet periode perseritje, llogaritur me relacionet e shuarjes Sadigh etj., 1997 dhe Spudich etj., 1999 (Aliaj etj., 2010).

6.0 VLERESIMI I RREZIKUT SIZMIK TE SHESHIT TE NDERTIMIT NE KUSHTET KONKRETE TE TRUALLIT ME ANEN E PROGRAMIT KOMPJUTERIK “SHAKE 2000”

6.1 Reagimi Dinamik i Modelit Gjeoteknik te Sheshit te Ndertimit

Per te studiuar sjelljen ndaj veprimit sizmik te modelit gjeoteknik te sheshit te ndertimit, u perdor programi kompjuterik “SHAKE 2000” per analizen 1- dimensionale te problemeve gjeoteknike te inxhinierise se termeteve (Gustavo A. Ordonez, Korrik 2011, i perditesuar Korrik 2013).

Perzgjedhja e regjistrimeve te serive kohore te akseleracionit te termeteve per t’u aplikuar si funksione hyres ne programin “SHAKE 2000” behet ne bazen e te dhenave “PEER”(te Qendres Kerkimore Pacifike te Inxhinierise se Termeteve) te regjistrimit te lekundjeve te forta.

Baza e te dhenave "PEER" te regjistrimit te lekundjeve te forta ka mundesi te gjera per kerkimin e completeve te regjistrimeve te serive kohore te akseleracionit te termeteve ne biblioteken e kesaj baze te dhenash, mbeshtetur ne:

- (1) Karakteristikat e regjistrimeve lidhur me M e termetit, tipin e shkeputjes gjeneruese, distancen dhe karakteristikat e sheshit te ndertimit,
- (2) Ne formen e spektrit te reagimit te regjistrimeve ne krahasim me spektrin e sheshit te ndertimit, dhe
- (3) Ne karakteristikat e tjera te regjistrimit (Technical Report for the PEER Ground Motion Database Web Application. Beta Version, October 1, 2010).

Nder kriteret me kryesore per kerkimin e regjistrimeve te duhura te serive kohore te akseleracionit jane "M" e termetit dhe tipi i shkeputjes qe ka gjeneruar ate termet. Keshtu ne rastin tone per vleresimin e rrezikut sizmik te sheshit te ndertimit ne Durres, se pari jane zgjedhur regjistrime te termeteve te ceket te gjeneruar nga zona me regjim ne shtypje (nga shkeputje te tipit mbihipje ose lart-rreshqitje) dhe me magnitude afer 7.0, potenciali sizmik i treves se jashtme – i Shqiperise Perendimore me regjim ne shtypje, sic jane akselerogramat e termeteve te ndodhur ne: Kaliforni - SHBA, Kanada, Armeni dhe Taivan etj.

Theksojme se ne rast te shesheve te ndertimit qe zene vend ne treven e brendeshme – ne Shqiperine Lindore me regjim te sotem ne zgjerim duhen kerkuar e gjetur regjistrime te termeteve te gjeneruar nga zona me regjim ne zgjerim (nga shkeputje normale). Regjistrime te termeteve te gjeneruar nga shkeputje normale huazohen nga vende s:i Italia, Greqia, Maqedonia etj.

Ne perputhje me kriteret e lartpermendur si funksione hyres per sheshe ndertimi ne qytetin e Tiranës jane perzgjedhur akselerograma te termeteve nga Taivani, SHBA, Kanadaja, Armenia etj., te regjistruar ne shkembinj rrenjesore.

Te gjitha keto akselerograma jane shkallezuar per nivelin e PGAm_{ax} te sheshit te ndertimit ne shkembinj rrenjesore, per nje nivel te caktuar probabiliteti (ose per nje periode te dhene perseritje te termeteve).

Shkallezimi i regjistrimeve te bazes se te dhenave te lekundjeve te forta kryhet duke aplikuar nje faktor linear shumezimi qe nuk ndryshon permbajtjen e frekuences relative te serive kohore

te akseleracionit. Ka dy opsione shkallezimi te regjistrimeve per te barazuar vlerat e tyre me spektrin e sheshit te ndertimit per nje seri periodash ose per nje periode te vetme. Ka edhe opsion te perdorimit te regjistrimeve te pashkallezuara.

Keshtu ne rastin e opsionit te shkallezimit te regjistrimeve per t'i barazuar me nje periode te vetme, psh me vleren e akseleracionit te nje sheshi ndertimi ne kushte trualli shkembor, faktori shumezues (f) llogaritet si vijon:

$$f = \text{PGAshesh ndertimi} / \text{PGAregjistrim termeti}$$

Vlerat e akseleracionit maksimal, te llogaritura me programin kompjuterik "SHAKE 2000" nga aplikimi si funksione hyres i termeteve te ndryshem, shumezohen me faktoret perkates shumezues – f per secilin termet, duke gjetur keshtu si akseleracionet maksimale – PGAm_{ax}, ashtu edhe faktoret e amplifikimit te truallit - FA ne thellesi te ndryshme te sheshit te ndertimit, dhe ne baze te tyre perlllogariten edhe vlerat e mesatarizuara te Amax-mes dhe FAmes, te paraqitura ne tabelat qe vijojne.

6.2 Nxitimi Maksimal (PGAm_{ax}) dhe Faktori i Amplifikimit Dinamik te Truallit (FA)

Per sheshin ne shqyrtim, nga baza e te dhenave "PEER"(Qendra Kerkimore Pacifike e Inxhinierise se Termeteve) e regjistrimit te lekundjeve te forta jane perzgjedhur regjistrime te serive kohore te termeteve bazuar ne:

- 1) Spektrin e sheshit te ndertimit per probabilitet 10 % / 50 vjet (475 vjet periode perseritje),
- 2) Tipin e shkeputjeve lartreshqitje-mbihipje (qe kane gjeneruar termete ne kete zone),
- 3) Magnituden $M = 6 - 7$ (magnituda e vleresuar nga regjistrimi i termeteve qe kane prekur zonen bregdetare Adriatike), dhe
- 4) Shpejtesine mesatare te valeve terthore per 30 m e siperm te prerjes gjeologjike te sheshit te ndertimit (te marre $V_s, 30 = 150-200$ m/sek, kur dihet se $V_s, 30 = 165$ m/sek per sheshin e ndertimit).

Bazuar ne keto kritere, per sheshin e ne Durres u perzgjedhen regjistrimet e serive kohore te termeteve qe tregohen ne Tabelen 2.

Nxitimet maksimale qe perfitohen ne tavanin e çdo shtrese te modelit gjeoteknik per te 6 funksionet hyres te aplikuar ne shkembinjte rrenjesore ne thellesine 40.00 m, per nivel probabiliteti 10 % / 50 vjet, jane paraqitur ne tabelen dhe figuren qe vijojne.

Te gjitha akselerogramat e perdorur si funksione hyres jane shkallezuar = shumezuar (zvogeluar ose zmadhuar) me nje faktor te caktuar per t'u barazuar me vleren e PGA = 0.268 g qe paraqet vleren e rrezikut sizmik per probabilitet 10 % / 50 vjet (ose per periudhe perseritje te termetit 475 vjet) ne shkembij rrenjesore per sheshin e ndertimit ne shqyrtim, dhe ne teresi per gjithe sheshet ne qytetin e Durresit (Aliaj etj., 2010).

Vlerat e llogaritura te akseleracionit ne shkembin baze me funksionet hyres te perzgjedhur ne perputhje me spektrin elastik te reagimit te akseleracionit te sheshit ne studim, ndryshojne nga PGA ne shkemb e sheshit konkret, perse duhet te llogaritet nje faktor shumezues - f, si vijon:

$f = \text{PGA shkemb e sheshit te ndertimit} / \text{PGA ne shkemb e llogaritur nga funksionet hyres}$.

Keshtu faktori shumezues per probabilitet 10 % / 50 vjet ne sheshin ne studim perlllogaritet si vijon:

Vlera e akseleracionit ne shkemb e sheshit te ndertimit eshte $\text{PGA}_{\text{rock}} = 0.268 \text{ g}$, dhe

Vlera e mesatarizuar e akseleracionit llogaritur nga 6 funksionet hyres ne shkemb per kete shesh rezulton te jete $\text{PGA}_{\text{mes-rock}} = 0.235 \text{ g}$,

Atehere faktori shumezues do te jete $f = \text{PGA}_{\text{rock}} / \text{PGA}_{\text{mes-rock}} = 0.268 / 0.235 = 1.14$.

